

QENDRA PËR PËRSOSMËRI NË MËSIMDHËNIE

PLANI I ZHVILLIMIT 2022-2023

Përmbajtja

Hyrje.....	1
Funksionalizimi i QPM	2
Zhvillimi i burimeve të QPM	3
Identifikimi i nevojave të stafit akademik për përsosmëri.....	4
Përcaktimi i aktiviteteve të tjera.....	5
Pasqyra tabelare e planit të zhvillimit.....	5

Hyrje

Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM), e cila u themelua me vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren më 12.03.2020, ka për qëllim të mbështes stafin akademik në zhvillimin e tij profesional. Duke u bazuar në dispozitet e statutit dhe të rregulloreve të universitetit, duke u mbështetur në vlerat dhe strategjinë që dalin nga këto dokumente dhe në përputhje me “Planin Strategjik 2020-2023”, QPM vazhdon të funksionojë sipas “Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e QMP” të nxjerrë më 29.06.2022. Në përputhje me bazën ligjore, kjo qendër paraqet një mekanizëm për arritjen e pikësnyimeve institucionale të universitetit tonë të përcaktuara me planin strategjik dhe në përputhje me kërkesat e Agjencionit për akreditim të Kosovës.

Pikësnyimet që qendra synon t’i arrijë janë rritja e nxënies akademike dhe ngritja e shkallës së të diplomuarëve duke i ofruar studentëve mësimdhënie cilësore dhe mbështetje akademike gjatë studimeve të tyre. Përbrenda kësaj kornize, qendra ndërmerr aktivitetet që synojnë ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe zhvillim profesional që mundëson rritjen e konkurrencës, mobilitetit dhe integritetit akademik të mësimdhënësve universitar të UHHP.

Ky dokument shpalos planin fillestar zhvillimor 2022/2023 të qendrës dhe është vazhdimësi e planit zhvillimor 2020/2021. Plani i tanishëm 2022/2023 përfshin funksionalizimin e QPM, zhvillimin e mëtejshëm të burimeve të saj, identifikimin e nevojave të mësimdhënësve për përsosmëri, përcaktimin e trajnerëve, përcaktimin e aktiviteteve tjera të qendrës dhe në fund jep pasqyrën tabelare të planit të zhvillimit.

Funksionalizimi i QPM

Duke u bazuar në nenet 4, 11, dhe 14 të Rregullores për funksionimin e QPM, hapat e para të përcaktuara për punën e kësaj qendre janë radhitur më poshtë:

1. Përcaktimi i hapësirës për kryerjen e punëve të QPM

Universiteti duhet të ndajë hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e punëve të qendrës. Hapësira/zyret duhet të jenë të pajisura me të gjitha pajisjet e nevojshme për një zyre administrative përfshirë kompjuter, kopjues, skaner dhe material shpenzues për zyre.

Kjo hapësirë duhet të caktohet më së largu deri në **fillim të muajit dhjetor 2022**.

2. Përzgjedhja e zyrtarit administrativ

Zyrtari/ja administrative ka për detyrë të ndërmarr kryerjen e punëve administrative të qendrës, t'i përgatit shkresat dhe dokumentet zyrtare, të kopjojë, t'i bart të dhënat në bazën elektronike të të dhënave, t'i përgatit tabelat dhe diagramet e ndryshme, të mbështes koordinatorin, stafin administrativ dhe trajnerët në punët e tyre, të mirëmbajë arkivën e qendrës dhe të ndihmojë në mbarëvajtjen e punëve administrative të qendrës.

Ky hap duhet të përmbahet deri në **fund të muajit dhjetor 2022**.

3. Ndarja e buxhetit për mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe shërbimeve të qendrës

Sipas nenit 14 të Rregullores për punën e qendrës, universiteti duhet të ndajë fonde për punën e qendrës në fazat e para të punës së saj derisa ajo të mund t'i arrij të funksionoj me kapacitet të plotë. Në vitet e ardhshme fiskale të universitetit, duhet të futet në planifikim buxhetor edhe fondi për QPM ashtu që ajo të mund të përballlet me shpenzimet që ndërlidhen me aktivitetet e saj.

Zhvillimi i burimeve të QPM

QPM tanimë i ka përzgjedhur organet e saj udhëheqëse përfshirë:

1. Këshillin administrativ i cili përbëhet nga një përfaqësues prej secilës njësi akademike, Prorektoren për çështje mësimore, përfaqësuesin e zyres për sigurimin e cilësisë dhe përfaqësuesin e studentëve.

Anëtarët e emëruar të këtij këshilli janë dhënë më poshtë:

1. Faruk Bojaxhi
 2. Fatlind Tredhaku
 3. Ilir Krusha
 4. Muharem Faiku
 5. Nora Rada
 6. Vedat Bajrami
 7. Venet Shala
 8. Zirije Hasani
2. Koordinatorin e QPM e cila u zgjodh me vendimin e Këshillit Drejtues nga radhët e mësimdhënësve të rregullt të universitetit,

Sermin Turtulla

3. Këshillin e trajnerëve të cilët u zgjodhën nga trajnerët e certifikuar dhe në marrëdhënie të rregullt pune në universitet me të drejtë vote në këshill:

Me të drejtë vote

1. Adelina Rakaj
2. Anera Alishani
3. Ercan Canhasi
4. Mirvjena Kortoci
5. Pranvera Jetishi
6. Serdan Kervan
7. Vjollca Dibra

Pa të drejtë vote:

1. Fatmir Mehmeti
2. Halim Bajraktari
3. Shefki Shtërbani
4. Vedat Bajrami
5. Zirije Hasani

Identifikimi i nevojave të stafit akademik për përsosmëri

Plani paraprak i zhvillimit 2020-2021, duke i marr parasysh nevojat e mësimdhënësve, kishte nxjerrë pesë kategori kryesore të trajnimeve përfshirë mësimdhënie/mësimnxënie, leadership dhe aftësi drejtuese, hulumtim, zhvillim i karrierës, dhe aftësim i gjuhës.

Plani aktual i zhvillimit përcakton dy kategori kryesore të interesit: mësimdhënia/mësimnxënia dhe hulumtimi. Këto kategori të trajnimeve janë përzgjedhur duke u bazuar në faktet si në vijim:

1. nevojat aktuale të stafit akademik,
2. aftësitë trajnuese të trajnerëve në përmbushjen e shërbimeve,
3. mundësinë kohore të realizimit të tyre përbrenda kapaciteteve të tanishme,
4. gjendjen e tanishme të ndërtimit dhe funksionalizimit të QPM, dhe
5. shkallën e përmbushjes së plotë të planit të hartuar.

Në bazë të dhënave nga Zyra për sigurimin e cilësisë, QPM identifikoi kërkesat e stafit akademik për përsosmëri profesionale të cilat janë përmbledhur në tabelën më poshtë:

Nr.	Kategoria	Trajnimet
1.	Mësimdhënia/mësimnxënia	Metodat bashkëkohore të mësimdhënies
		Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie
		Përdorimi i softuerit për testime online
		Metoda e mësimit studenti-në-qendër
		Punëtori për punën në laboratore
2.	Hulumtimi	Punëtori për metodat e hulumtimit
		Trajnime për mentorimin e temave të diplomave
		Organizimi i vizitave studimore në/jashtë vendit

Sipas planit fillestar, QPM ka përzgjedhur 10 trajnerë nga radhët e mësimdhënësve të universitetit, të cilët janë trajnuar nga trajnerët e Qendrës për përsosmëri në mësimdhënie të Universitetit të Prishtinës dhe nga trajnerët e projektit HERAS me mbështetje ndërkombëtare në shtator dhe tetor 2022. Këta trajnerë janë trajnuar për shumë tema përfshirë teorinë e të nxënësve, stilet e të nxënësve/mësuarit, menaxhimi i klasës, shkathhtësitë e prezentimit, vlerësimi i studentëve, hartimi i rezultateve të të nxënësve (taksonomia e

Bloomit), teknikat ndërvepruese të mësimdhënies, mësimdhënia e bazuar në kërkime, mësimdhënia universitare aktive dhe ndërvepruese, mësimi problemor, hulumtimi në veprim, dhe hartimi i planprogramit semestral (syllabusit). Tanimë trajnerët janë aftësuar të mbajnë trajnime dhe janë në gjendje të organizojnë trajnime në fushat e tyre të caktuara për stafin akademik të UUHP.

Me ndihmën e tyre, qendra synon t'i ofrojë trajnimet e para gjatë muajit **dhjetor 2022 - prill 2023**.

Përcaktimi i aktiviteteve të tjera

Bazuar në nenet 4 dhe 5 të Rregullores për punën e QPM dhe përbrenda kornizës ligjore të aktiviteteve të saj, kjo qendër në planin e dytë të zhvillimit të saj parasheh edhe aktivitetet e tjera që ndërlidhen me funksionalizimin dhe shërbimdhënien më frytdhënëse, e të cilat aktivitete kërkojnë edhe mbështetjen e menaxhmentit të lartë dhe të akterëve të tjerë të cilët do të përfitojnë nga puna e suksesshme e qendrës. Kështu zhvillimi i planeve të përbashkëta me qendrat e tjera të përsosmërisë dhe me Drejtorinë komunale të Arsimit në Prizren do të ndihmonin në bashkërenditjen e kërkesave të tregut me shërbimet e qendrës. Këtu janë të rëndësishme edhe bashkëpunimet e qendrës me zyret e tjera të universitetit si janë zyra për ERASMUS, bordi industrial këshilldhënës, dhe zyra për çështje akademike.

Takimet e para planifikohen të organizohen në **Shkurt- Prill 2023**.

Plani vjetor i zhvillimit 2022-2023

Në bazë të dhënave të deritanishme të shpalosura më lart, QPM ka hartuar planin fillestar të zhvillimit 2022-2023 të pasqyruar në planin e zhvillimit dhe planin kalendarik të trajnimeve më poshtë.

Aktiviteti	Emërtimi	Koha e realizimit	Realizimi
Funksionalizimi	Zyra e QPM	fillim të muajit dhjetor 2022	Godina e ekonomisë, ITP
	Zyrtari administrativ	fund të muajit dhjetor 2022	Një zyrtar i përkohshëm
	Ndarja e buxhetit	viti i ri fiskal	në pritje
Trajnimet	Stilet e të nxënit	Dhjetor 2022	2gr/15prs
	Shkathësitë e menaxhimit të situatave sfiduese në klasë	Janar 2022	
	Shkathësitë e prezentimit dhe bartjes së informatave	Shkurt 2022	
	Metodat ndërvepruese të ligjërimit	Mars 2022	
	Mësimnxënia aktive	Prill 2022	
	Kërkesa tjera nga mësimdhënësit		
Bashkëpunimi	Takimet me DKA	Shkurt 2023	
	Takimet me QPM të universiteteve tjera	Shkurt 2023	
	Takimet me zyren ERASMUS	Prill-maj 2023	